

Ribotim i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.505, datë 1.5.2008,
(botuar në Fletoren 69, datë 21 maj 2008).

VENDIM
Nr.505, datë 1.5.2008

**PËR PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE NGA PRIVATIZIMI I PAKETËS SË
AKSIONEVE SHTETËRORE TË MBETURA TË AMC SHA-SË, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.410, DATË 11.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR TRANSFERIMIN E PAKETËS SË AKSIONEVE TË AMC SHA-SË, QË KA
MBETUR PAS TRANSFERIMIT TË PAKETËS TEK INVESTITORËT STRATEGJIKË,
TEK ISH-PRONARËT E TRUALLIT DHE TE PUNONJËSIT E KËSAJ SHOQËRIE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.8515, datë 21.7.1999 “Për privatizimin e shoqërisë anonime “Albanian Mobile Communication (AMC)” dhe të pikës 9 të nenit 5 të ligjit nr.8660, datë 18.9.2000 “Për ratifikimin e kontratës për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime AMC”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ardhurat e realizuara nga shitja e paketës së aksioneve shtetërore, të mbetura në shoqërinë anonime AMC, të derdhen në Buxhetin e Shtetit dhe të përdoren për mbulimin e:

- shpenzimeve të kryera nga kjo shoqëri për procesin e shitjes së aksioneve investitorit strategjik, në vlerën 24 880 880 (njëzet e katër milionë e tetëqind e tetëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë;

- shpenzimeve për shitjen e paketës shtetërore të aksioneve të mbetura, në vlerën 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë;

- detyrimit tatimor para privatizimit, në vlerën 80 922 670 (tetëdhjetë milionë e nëntëqind e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë;

- pagesës së huasë së “Albbakër”, sha-së, që i ka kësaj shoqërie, në vlerën 21 000 000 (njëzet e një milionë) lekë.

2. Pika 2 e vendimit nr.410, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Shpenzimet për realizimin e procedurave të përzgjedhjes së konsulentit për shërbimet e tij, si dhe shpenzimet e tjera, të nevojshme për transferimin e paketës, të përballohen nga të ardhurat e realizuara nga shitja e paketës së aksioneve shtetërore, të mbetura në shoqërinë anonime AMC.”.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha